

PSH.nr.66/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.P “Euro Construction”-Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Triagle” SH.P.K.-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shkollave Gjini Gazuli dhe Ahmet Gashi” Lot 1, me nr. të prok: 616-20-4816-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, më datën: 25.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.N.P “Euro Construction”-Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave Gjini Gazuli dhe Ahmet Gashi” Lot 1, me nr. të prok: 616-20-4816-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave Gjini Gazuli dhe Ahmet Gashi” Lot 1, me nr. të prok: 616-20-4816-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.P “Euro Construction”-Rahovec, i aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.N.P “Euro Construction”-Rahovec, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 21.01.2021 me nr. 66/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shkollave Gjin Gazuli dhe Ahmet Gashi” Lot 1, me nr. të prok: 616-20-4816-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe neni 60 të LPP-së, te ankesa me nr. 66/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 29.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.N.P “Euro Construction”-Rahovec

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur me vlerë të mesme, lloji i kontratës është punë. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës në lotin 1. Të njëjtin rekomandim parashtruesi i ankesës e ka kontestuar përmes kërkesës për ri shqyrtim megjithatë AK – Komuna Prishtine e ka refuzuar kërkesën me arsyetimin kryesore se, parashtruesi i ankesës ka çmime me te ulëta se operatori ekonomik “Triangle” sh.p.k, i rekomanduar për dhënie ne lotin 1.

Përgjigje në pretendimin ankimore (neni 113):

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK-Komuna Prishtine, përkatësisht komisioni vlerësues, fillimisht kishte rekomanduar për dhënie te kontratës

parashtruesin e ankesës OE NNP “Euro Construction”- Rahovec, rrjedhimisht kishte eliminuar operatorin tani të rekomanduar për dhënie në lotin 1 dhe atë me arsyetimin: “Gjatë vizitës në depon e OE, komisioni në përbërje të zyrtarëve z. Ylber Jashari dhe Bashkim Statovci, kanë vërejtur se deklaratimet e OE se disa nga materialet nga pozicionet e vlerësuara si çmime jo normalisht të ulëta, ka sasi në deponinë e tyre në depon e OE, nuk janë të sakta. Pozicionet nga para masa 2.1 dhe 3.2 gjatë inspektimit është konstatuar se OE nuk ka asnjë sasi në depo sipas deklaratës së dhënë. Pozicioni nga para masa 3.1 është vlerësuar se OE ka në deponinë e tij sasi për mbulimin vetëm të 300 metrave katrore sipas përshkrimit 2+2” -Si provë së bashku me raport gjeni letrën standarde të datës 06.11.2020. AK – Komuna Prishtine, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë për disa nga pozicionet e ofertës financiare të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, sqarimet e ofruara janë trajtuar jo bindëse dhe jo reale nga AK. Përderisa nga parashtruesi i ankesës nuk është kërkuar sqarim fare, megjithatë përmes vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim arsyetohet se OE ankues ka pozicione edhe më të ulëta se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës. Sipas asaj që u tha më lartë vlerësimi ynë është se AK – Komuna Prishtine, nuk i ka trajtuar në mënyrë të drejtë ofertuesit sipas parimeve bazë të prokurimit, përkundër faktit se kjo është potencuar edhe përmes arsyetimit të vendimit të kërkesës për ri shqyrtim mirëpo edhe përmes ri vlerësimit nuk është kërkuar sqarim shtesë për ofertën apo pozicionet që duken apo janë jo normalisht të ulëta të OE ankues. Ofertat financiare të OE të rekomanduar dhe OE ankues janë rreth 70% të vlerës së parashikuar për Lot 1. - Prandaj propozimi ynë për AK – Komuna Prishtine, është që lëndën ta kthej në ri vlerësim në mënyrë që të behet vlerësim real i ofertave, të trajtohen në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik sipas depozitave ligjore.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NNP “Euro Construction”- Rahovec, të aprovohet si e bazuar, të anulohet propozimi për dhënie të kontratës, dhe loti 1 të kthehet në Ri Vlerësim.

Organi Shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 01.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik N.N.P “Euro Construction”- Rahovec me datë 01.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përgjigje në ekspertizën Nr.66/21 TË DT.29.01.2021

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr.66/21 të dt.29.01.2021 dhe në vazhdim po i japim përgjigjet tona lidhur me konstatimin e ekspertit shqyrtues.

Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në rivlerësim, mirëpo nuk pajtohemi plotësisht me ekspertizën e tij, sepse nuk i ka shqyrtuar në tërësi të gjitha pretendimet tona ankimore. Eksperti shqyrtues në konstatimin e tij i referohet vetëm faktit se nga ana e AK-së nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë ofertuesit sipas parimeve bazë të prokurimit, mirëpo nuk i ka marrë parasysh fare pretendimet tona ankimore ku e kemi cekur se “OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka pasur sasi të materialeve në momentin e ofertimit, të cilat ka pretenduar se i ka në stok, andaj nuk ka asnjë mundësi ligjore dhe praktike të shpallet fitues ky operator ekonomik. Pra edhe nëse eventualisht OE i rekomanduar për kontratë tani i posedon sasi të materialeve që i kanë munguar atëherë, i njëjti operator ekonomik nuk duhet ligjërisht të shpallet i përgjegjshëm sepse ato materiale ka mundur ti blejë pas eliminimit të parë. Prandaj nuk duhet lejuar që OE tani i rekomanduar për kontratë të bëhet i përgjegjshëm, sepse ky fakt do të përbënte favorizim ekstrem dhe do të binte në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.” Gjithashtu eksperti shqyrtues nuk ka konstatuar fare se a është apo jo pretendimi ynë ankimor i bazuar, ku e kemi cekur se “OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se tek pozicionet 2.1 dhe 3.2 ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta, ku për të cilat ka deklaruar se posedon sasi të materialeve në stok, mirëpo që pas inspektimit të komisionit vlerësues të AK-së është vërtetuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë sasi në depo.” Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria jonë dhe papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 16.02.2021, të mbajtur nëpërmjet platformës elektronike ZOMM në ora 10:00, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së nuk ka qenë prezent në seancë, eksperti shqyrtues.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankuesi i cili deklaroi: Ne pretendimet tona i kena shpreh edhe në ankesën tonë, ne pajtohemi me mendimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim por nuk pajtohemi me ekspertin pasi që OE i rekomanduar për kontratë nuk e shpall si të pa përgjegjshëm pasi të njëjti vet AK në vlerësimin e parë e ka shpall të pa përgjegjshëm për shkak të çmimit. OE i rekomanduar për kontratë ka deklaruar se të njëjtat materiale i posedon në stok pas kësaj AK perses komisionit ka dalë në teren dhe e ka vizituar stokin e të

njëjtë OE dhe asnjërin nga materialet nuk i posedon në stok ashtu siç ka deklaruar andaj edhe në vendimin e parë e ka shpall si të pa përgjegjshëm dhe në vendimin e dytë nuk e di si AK e shpall po të njëjtin si OE të përgjegjshëm edhe pse pas vendimit të dytë OE ka mund të sjell materialet aty mirpo ato janë vetëm as vendimin të parë dmth ai në vendimin e parë është shpallur se nuk i ka poseduar ato materiale sa i përket krahasimit që AK i ka bërë ofertave tona në mendojmë që AK duhet të krahasoj çmimet tona me çmimet e tregut e jo çmimet mes ofertave të OE të cilën mendoj që është krejtësisht e pa nevojshme sepse në kemi çmimet e tregut nuk pretendojmë të krahasojmë çmimet me OE të cilët pretendojnë për të njëjtën kontratë andaj edhe ky është pretendimi kryesor i joni që OE që është rekomanduar për herën e dytë për kontratë është i pa përgjegjshëm për shkak se vet AK e ka shpallur herën e parë të pa përgjegjshëm edhe nuk i ka përmbajtur deklaratave të veta të cilat ka pretenduar që i ka materialet e komisioni në terren e ka vlersu te kundërtën kjo është. I propozojmë panelit që OE i shpallur për herë të dytë për kontratë të shpalljet i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka përmbushur deklaratimet të cilat i ka dhënë ndaj AK dhe të aprovohet ankesa jonë dhe të shpallet i pa përgjegjshëm dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

AK nuk thotë që ti i ka çmimet jo normalisht të ulëta, thotë se ti i ka disa pozicione më të lira me OE rekomanduar për kontratë dmth nuk mi qet që çmimet e mija janë jo normalisht ulët vetë i qet i krahason me pozicionet e OE rekomanduar për kontratë, i krahason të mijat me të tija ku thotë, këtu e ke 20 cent ma lirë se OE ose këtu 5 cent ma lirë për metër katror që do të thotë nuk i konteston çmimet e mija që i kam jo normalisht të ulëta por i konteston vetë se i kam disa nga çmimet e mija më ulët se OE.

Në vazhdim fjalën ia dha ekspertit shqyrtues z. Bibaj i cili deklaroj : unë kam propozuar që lënda mu kthejë në rivlerësim pasi që OE tani i rekomanduar për dhënie fillimisht ka qenë i eliminuar nga komisioni vlerësues me arsyetimin se i njëjti ka ofertuar me pozicione jo normalisht të ulët sipas përshkrimit me arsyetimin të eliminimit të cilin e kam bashkëngjitur si provë bashkë në raport është pretenduar se pas kërkesës për sqarim OE është deklaruar se komisioni dhe disa nga anëtarët e komisionit kanë dalë në terren dhe kanë deklaruar se për disa pozicione materiale që ky ka ofertuar nuk janë të sakta në kuptimin që nuk ka kurrfarë sasive në deponi megjithatë pas kërkesës për rishqyrtim i njëjti është rekomanduar për dhënie dhe arsyetimi ka qenë se edhe ankuesi ka pozicione të tilla kjo pra bje ndesh me parimet bazike të LPP prandaj edhe unë kam propozuar që lënda mu kthejë në rivlerësim dhe mu trajtoj njëjtë të gjithë ofertuesit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesës së OE ankues, sqaron se në lidhje me pretendimin e OE ankues se AK fillimisht e ka shpallur fitues OE ekonomik N.N.P "Euro Construction"-Rahovec tani ankues, kurse OE tani të rekomanduar e kishte eliminuar si OE të papërgjegjshëm me arsyetimin se komisioni në përbërje të zyrtarëve Ylber Jashari dhe Bashkim Statovci kanë vërejtur se disa nga materialet për pozicionet e vlerësuara si çmime jo normalisht të ulëta nuk janë në depo dhe nuk janë arsyetuar mjaftueshëm. Pastaj, OE ankues

pretendon se përdersia anëtarët e lartcekur të komisionit kanë vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka sasi të materialeve në depo për disa pozicione të cilat janë konsideruar me çmime jo normalisht të ulëta, si ka mudnësi që AK-ja ta rekomandojë për kontratë një OE të tillë. Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se kontestohen vetëm çmimet e disa pozicioneve të OE të rekomanduar, konkretisht pozicioni 2.1 dhe 3.2 i ofertës së OE të rekomanduar. Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues vlerëson se qëllimi i Rregullave për Tenderët jo normalisht të ulët është që të jepen sqarime për autoritetet kontraktuese në lidhje me konceptin e tenderit jo-normalisht të ulët i cili i referohet atyre tenderëve që në shikim të parë duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat apo ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës. Pra, shihet nga vet qëllimi i këtij rregulli se ka të bëjë me çmimin e tenderit dhe jo me pozicionet. Në rastin konkret për këtë aktivitet të prokurimit, pozicionet e paramasës janë të varura nga njëra tjetra dhe duhet të implementohet e tërë paramasa për realizimin e kësaj kontrate sepse nuk është kontratë kornizë, si dhe dihet që operatorët ekonomik duhet në pozicione të caktuara të ofrojnë me çmime më të lira se konkurrent. Gjithashtu, paneli shqyrtues konstaton se nuk është plotësuar kushti 1, çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; për tender jo-normalisht të ulte, të miratuara nga KRPP.

Sa i përket pikës se AK fillimisht e ka rekomanduar për dhënie të kontratës parashtruesin e ankesës OE NNP "Euro Construction"- Rahovec, rrjedhimisht kishte eliminuar operatorin tani të rekomanduar për dhënie në lotin 1 pasi ka kërkuar sqarime shitesë për disa nga pozicionet e ofertës financiare të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, kurse nga parashtruesi i ankesës nuk është kërkuar sqarim fare. Paneli Shqyrtues sqaron se zbatimi i rregullave për tenderët jo normalisht të ulët duhet të bëhet në ato raste kur çmimi i tenderit është më i ulët 30% se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm. Në rastin konkret, nuk kontestohet çmimi i tenderit të OE ankues e as tenderi i OE të rekomanduar për pozicione të caktuara. Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankues për mos trajtim të barabartë nuk është i bazuar sepse AK këtë mostrajtim e ka bërë gjatë vlerësimit të ofertave herën e parë, dhe kjo ka qenë arsyeja pse lënda është kthyer në rivlerësim. Rivlerësimi i ofertave nënkupton piken zero, dmth vlerësimin e ofertave nga fillimi, e që në rastin konkret, AK nuk ka kërkuar sqarime nga asnjëri OE pasi që asnjë ofertë nuk ka çmimin e tenderit më të ulët 30% se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm. Prandaj Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është

respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Prishtinë";
- 1x1 OE N.N.P "Euro Construction"-Rahovec;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.